



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS**  
Komora Farmaceuta Kosova  
Kosova Chamber of Pharmacists



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës  
Komora Farmaceuta Kosova  
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 39 Dt. 08.08.2019

**RREGULLORE PËR  
LICENCIMIN DHE RILICENCIMIN E FARMACISTËVE**

Prishtinë, 2019

**KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS**, në mbështetje të nenit 19, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1, në lidhje me nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, nenit 20, paragrafin 1, në lidhje me nenin 15, paragrafi 2 dhe 3 të Statutit të Odës së Farmacistëve të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29/06/2019, nxjerrë këtë:

## **RREGULLORE PËR LICENCIMIN DHE RILICENCIMIN E FARMACISTËVE**

### **KREU I - DISPOZITA E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohet procedura e aplikimit, kriteret për licencimin dhe rilicencimin e farmacistëve dhe specialistëve të farmacisë si dhe mirëmbajtja e regjistrit të licencave të lëshuara dhe revokuara nga OFK-ja.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

Procedura dhe kriteret e parapara për licencim dhe rilicencim me këtë rregullore zbatohen vetëm ndaj farmacistëve shtetas të Republikës së Kosovës.

#### **Neni 3 Përkufizimet**

Termet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

**Licencimi** – procedura për dhënien e lejes profesionistit shëndetësor që të merret me veprimtari shëndetësore në Kosovë dhe që është i autorizuar ta ushtrojë veprimtarinë shëndetësore në pajtim me ligjet e zbatueshëm në Kosovë

**Rilicencimi** – procedura për vazhdimin e lejes profesionale të profesionistit shëndetësor

**Komisioni** – nënkupton Komisionin për Licencim të OFK-së

**KEVP** - nënkupton Komisionin për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

**Kartelë e identifikimit të anëtarësisë** – nënkupton ID/ Certifikatën e anëtarësisë me të cilën dëshmohet se personi është anëtar në OFK.

**Shërbimi Profesional i OFK-së** – nënkupton zyrën administrative të OFK-së

## **Neni 4**

### **Komisioni për Licencim**

1. Komisioni për Licencim është komision i përhershëm i OFK-së përgjegjës në ushtrimin e këtyre kompetencave dhe përgjegjësive:
  - 1.1. Mirëmbajtjen e regjistrave zyrtarë të anëtarëve të OFK-së;
  - 1.2. I rekomandon Këshillit Drejtues të paraqesë në Kuvend ndryshimin e akteve ligjore me të cilat rregullohet fushëveprimtaria e këtij Komisioni;
  - 1.3. Vendos në shkallë të parë mbi përmbyshjen e kushteve për regjistrimin, licencimin, rilicencimin e farmacistëve dhe njohjen e licencave të farmacistit të lëshuara jashtë vendit brenda kompetencave të veta;
  - 1.4. Revokimin e përkohshëm apo të përhershëm të licencës të farmacistit pas rekomandimit të Këshillit Etik (në rast ankese pas përfundimit të shqyrtimit të ankesës nga Gjyqi i Nderit);
  - 1.5. Bashkëpunimin me organet e tjera në përmbyshjen e kompetencave të OFK-së, të cilat janë në përputhje me fushëveprimin e këtij komisioni.

## **KREU II – PROCEDURA E APLIKIMIT PËR LICENCIM DHE RILICENCIM**

### **Neni 5**

#### **Procedura e aplikimit**

1. Farmacisti inicion procedurën e licencimit dhe rilicencimit përmes parashtrimit të aplikacionit dhe dokumentacionit Shërbimit Profesional të OFK-së, ose aplikacion elektronik. (Aneksi 1 dhe 2).
2. Shërbimi Profesional një kopje të aplikacionit të nënshkruar dhe vulosur nga zyrtari i OFK-së i dorëzon aplikuesit, ose vërtetimi pas validimit.
3. Shërbimi Profesional i OFK-së aplikacionin për licencim pas validimit së bashku me dokumentacion i procedon te komisioni për licencim.
4. Aplikacionet për rilicencim procedohen në komisionin për edukim të vazhdueshëm profesional për valorizimin e pikëve kredituese të farmacistëve.
  - 4.1. KEVP lëshon vërtetim mbi valorizimin e pikëve kredituese.
  - 4.2. Dosja e aplikuesit për rilicencim pas lëshimit të vërtetimit mbi valorizimin e pikëve, i procedohet Komisionit për Licencim për vendosje.

## **KREU III – KRITERET DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR LICENCIM DHE RILICENCIM**

### **Neni 6**

#### **Kriteret dhe dokumentacioni për licencim të farmacistëve/specialistëve të farmacisë**

1. Kriteret për licencimin e farmacistëve/specialistëve të farmacisë janë:
  - 1.1. Plotësimi i aplikacionit,
  - 1.2. Letërnjoftimi – me të cilin dëshmohet shtetësia e Republikës së Kosovës,
  - 1.3. Kartela e identifikimit e anëtarësisë në OFK me të cilën dëshmohet anëtarësia në Odën e Farmacistëve të Kosovës,
  - 1.4. Certifikata e provimit profesional për licencë - me të cilën dëshmohet dhënia e provimit profesional për licencë,
    - 1.4.1. Për specialistët edhe certifikata e provimit specialistik
  - 1.5. Deklarata nën betim,
  - 1.6. Pagesa e taksës administrative për licencë.

### **Neni 7**

#### **Kriteret dhe dokumentacioni për rilicencim të farmacistëve/specialistëve të farmacisë**

1. Kushtet për rilicencim të farmacistëve/specialistëve të farmacisë:
  - 1.1. Plotësimi i aplikacionit,
  - 1.2. Letërnjoftimi – me të cilin dëshmohet shtetësia e Republikës së Kosovës,
  - 1.3. Kartela e identifikimit e anëtarësisë në OFK me të cilën dëshmohet anëtarësia në Odën e Farmacistëve të Kosovës,
  - 1.4. Të ketë vërtetimin e KEVP mbi valorizimin e pikëve në përputhje me rregulloren për edukim të vazhdueshëm profesional,
  - 1.5. Të dorëzojë licencën origjinale të skaduar (ose 30 ditë para skadimit),
  - 1.6. Deklarata nën betim,
  - 1.7. T'i ketë paguar taksat administrative për anëtarësim,
  - 1.8. Ta ketë paguar taksën administrative për licencë.

### **Neni 8**

#### **Rilicencimi i farmacistëve të cilët nuk plotësojnë kriteret e EVP për rilicencim**

1. Farmacistët të cilët nuk përmbushin kriterin nga neni 14 dhe 15 të rregullores për KEVP do t'i nënshtrohen provimit për rilicencim.
2. Provimi për rilicencim organizohet nga komision i posaçëm i emëruar nga Këshilli Drejtues.

3. Anëtarët e komisionit duhet të kenë të përfunduara studime pasdiplomike (për personat që kanë përfunduar jashtë shtetit nevojitet nostrifikimi i diplomës nga MASHT), dhe të paktën njëri prej tyre duhet të ketë titullin e profesorit universitar.
4. Anëtari i OFK-së i cili ka paraqitur kërkesën për provim njoftohet së paku 15 ditë para datës së caktuar për provim.
5. Kërkesës për provim i bashkohet vërtetimi i KEVP për mosplotësim të kriterit për rilicencim së bashku me pagesën e taksës administrative për provim.
6. Provimi përbëhet nga pjesa me shkrim. Suksesi i kandidatëve në provim vlerësohet nga Komisioni me “kaloj” ose “nuk kaloj”. Dosja e kandidatit është konfidenciale.
7. Nëse kandidati vlerësohet në përfundim të testimit me shkrim me “nuk kaloj”, atëherë ai duhet t’i nënshtrohet riprovimit.
8. Në riprovim anëtari paguan taksë të re administrative.

## **KREU V – PËRMBAJTJA E APLIKACIONIT**

### **Neni 9**

1. Aplikacioni për licencimin, rilicencimin e farmacistëve dhe specialistëve përbëhet nga dy pjesë.
2. Pjesa e parë plotësohet nga aplikuesi dhe përmban të dhënat personale të tij:
  - 2.1. Emri dhe mbiemri;
  - 2.2. Nr. licencës;
  - 2.3. Vendi dhe data e lindjes;
  - 2.4. Adresa e vendbanimit;
  - 2.5. Institucioni në të cilin ka diplomuar, data e diplomimit dhe nr. diplomës;
  - 2.6. Lloji i specializimit dhe data e specializimit (vetëm për specialist);
  - 2.7. Numri i telefonit;
  - 2.8. Adresa e e-mail;
  - 2.9. Nënshkrimi;
  - 2.10. Deklaratën se me nënshkrimin e aplikuesit e gjithë përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e tij.

3. Pjesa e dytë përmban të dhënat mbi dokumentacionin e dorëzuar në OFK dhe nënshkrimin e zyrtarit të OFK-së i cili ka pranuar aplikacionin. Kjo pjesë plotësohet nga zyrtari i OFK-së. Në sistemin elektronik bëhet validimi elektronik.

## **KREU VI - SHQYRTIMI, VENDIMET E KOMISIONET DHE E DREJTA NË ANKESË**

### **Neni 10**

#### **Afati kohor i shqyrtimi të kërkesës**

Komisioni për Licencim jo më vonë se 30 ditë nga pranimi i kërkesës për licencim ose rilicencim është i obliguar të shqyrtojë atë dhe të vendosë në lidhje me të.

### **Neni 11**

#### **Vendimi për miratimin e kërkesës**

Komisioni për Licencim e miraton kërkesën në rast se janë të plotësuara të gjitha kushtet e parapara me këtë rregullore.

### **Neni 12**

#### **Vendimi për refuzimin e kërkesës**

1. Në rastet kur aplikacioni përmban mangësi në plotësimin e dokumentacionit, komisioni mund të caktojë afat shtesë jo më shumë se 15 ditë nga shqyrtimi i aplikacionit për plotësimin e lëndës.
2. Nëse brenda këtij afati aplikuesi nuk vepron sipas kërkesës së Komisionit, kërkesa e tij refuzohet me vendim.
3. Komisioni refuzon kërkesën edhe në rastet kur ndaj aplikuesit ekzekutohet masa disiplinore e tërheqjes së përkohshme ose të përhershme të licencës ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri.

### **Neni 13**

#### **E drejta në ankesë**

1. Pala e pakënaqur me vendimin e komisionit për refuzimin e kërkesës për rilicencim, ka të drejtë ankesë në afat prej 8 ditësh nga marrja e vendimit.
2. Ankesa i drejtohet Këshillit Drejtues të OFK-së.

3. Këshilli Drejtues i OFK-së është i obliguar që jo më vonë se 15 ditë nga pranimi i ankesës ta shqyrtojë atë.
4. Nëse Këshilli Drejtues e vendos se ankesa e tillë është e bazuar, merr vendim për licencimin e ankuesit, duke obliguar Komisionin për Licencim ta regjistrojë në regjistrin e lëshimit të licencave.

## **KREU VI – LICENCA**

### **Neni 14**

#### **Lëshimi i licencës dhe faksimili**

1. Licenca e OFK-së – origjinal lëshohet vetëm në një kopje.
2. Licenca mund të përdoret vetëm nga farmacisti titullar i licencës.
3. Një kopje e origjinalit të licencës së lëshuar ruhet në dosjen e aplikuesit.
4. Vendimi i komisionit për miratimin e kërkesës, konsiderohet autorizim për kryetarin/en e komisionit për nënshkrim të licencës.
5. Kryetari i Komisionit nënshkruan licencën në ditën kur miratohet nga komisioni, apo sa më parë që është e mundur.
6. Nënshkrimi i Kryetarit/es së Komisionit për Licencim konsiderohet rekomandim për Kryetarin e OFK-së për nënshkrimin e licencës.
7. Me rastin e lëshimit të licencës, të licencuarit me kërkesën e tij i dorëzohet faksimili, i cili shërben si shenjë e identifikimit profesional.
8. Faksimili ka këtë përmbajtje:
  - 8.1 Mbishkrimin “Oda e Farmacistëve të Kosovës - OFK”;
  - 8.2 Emrin dhe mbiemrin e të licencuarit;
  - 8.3 Thirrjen profesionale për të cilën është licencuar; dhe
  - 8.4 Numrin e licencës.
9. Madhësia dhe lloji i shkronjave në faksimil përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues të OFK-së.

10. Pronar i faksimilit është OFK-ja dhe me rastin e skadimit të licencës, i licencuari është i obliguar që të dorëzojë faksimilin me rastin e dorëzimit të licencës së skaduar për të cilën është lëshuar faksimili i tillë.

### **Neni 15** **Vlefshmëria kohore e licencës**

Licenca e OFK-së lëshohet në afat prej 5 (pesë) viteve duke filluar nga data e vendimit të Komisionit për Licencim, përveç rasteve të parapara ndryshe me Ligj.

### **Neni 16** **Licenca e shumëfishtë**

Farmacisti mund të jetë titullari i njëkohshëm i licencës për ushtrimin e profesionit si farmacist dhe si specialist në lëmi të farmacisë.

### **Neni 17** **Licenca e humbur**

1. Në rastet e humbjes së licencës, i licencuari njofton me shkrimin OFK - për humbjen e saj.
2. Komisioni për Licencim verifikon dosjen e të licencuarit dhe vendos për kërkesën e tij.
3. Komisioni licencën e re e lëshon në datat e vlefshmërisë të licencës së humbur dhe në licencë shënohet D U P L I K A T.

### **Neni 18** **Përmbajtja e licencës**

1. Licenca e lëshuar përmban këto të dhëna:
  - 1.1. Pjesën hyrëse në të cilën shënohet baza juridike e lëshimit të licencës;
  - 1.2. Emri dhe mbiemri i të licencuarit;
    - 1.2.1. Thirrja profesionale, përfshirë këtu specializimin apo subspecializimin;
    - 1.2.2. Data dhe vendi i lindjes;
    - 1.2.3. Numri i diplomës apo certifikatës së specializimit
    - 1.2.4. Numri i licencës;
      - 1.2.4.1.1. Numrat e licencës harmonizohen me nr. e MSH.
    - 1.2.5. Data e lëshimit dhe data e skadimit të licencës;
    - 1.2.6. Numri personal;
    - 1.2.7. Nënshkrimi i Kryetarit të Komisionit për Licencim dhe Kryetarit të OFK-së;



- 1.2.8. Vula e OFK-së e vendosur në mes të nënshkrimit të Kryetarit të Komisionit për Licencim dhe Kryetarit të OFK-së.
- 1.3. Të dhënat në licencë shënohen në tri gjuhë: shqipe, serbe dhe angleze;
- 1.4. Kodi i licencës së specialistit është kodi i licencës së farmacistit duke i shtuar edhe kodin e specializimit;
- 1.5. Licenca mund të nënshkruhet edhe nga personi i autorizuar nga Kryetari i Komisionit për Licencim ose Kryetari i OFK-së.

### **Neni 19** **Tërheqja e licencës**

1. Licenca mund të tërhiqet vetëm personalisht nga titullari i licencës, ose me autorizim të noterizuar të titullarit.
2. Me rastin e tërheqjes i licencuari duhet të nënshkruhet në librin e tërheqjes së licencave.
3. Në libër duhet të përmbajë:
  - 3.1. Emrin dhe mbiemrin e të licencuarit;
  - 3.2. Numrin e licencës;
  - 3.3. Datën e tërheqjes së licencës;
  - 3.4. Nënshkrimin e titullarit të licencës.

### **Neni 20** **Masa disiplinore e tërheqjes së përkohshme ose të përhershme të licencës ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri**

1. Komisioni i Licencimit është kompetent për tërheqjen e përkohshme ose të përhershme të licencës dhe fshirjen e profesionistëve shëndetësorë nga regjistri i anëtarëve.
2. Komisionin i Licencimit ekzekutimin e kësaj mase e bën në mbledhjen e parë të saj pas rekomandimit të Këshillit Etik ose vendimit të Gjyqit të Nderit në rast ankese nga pala.
3. Komisioni i Licencimit pas ekzekutimit e njofton organin kompetent se ka zbatuar këtë vendim, në mënyrë që organi kompetent të regjistrojë këtë masë në regjistrin e masave disiplinore të anëtarëve të Odës.

## **KREU VII – REGJISTRI I LICENCAVE TË LËSHUARA DHE REVOKUARA**

### **Neni 21**

#### **Regjistri i licencave të lëshuara dhe revokuara**

1. Komisioni për Licencim mban regjistrin e të gjitha licencave të lëshuara dhe revokuara.
2. Regjistri i licencave përmban:
  - 2.1. Emrin dhe mbiemrin e farmacistit,
  - 2.2. Numrin e licencës,
  - 2.3. Datën e lëshimit të licencës,
  - 2.4. Datën e skadimit të licencës.
3. Regjistri i revokimit të licencave përmban:
  - 3.1. Emrin dhe mbiemrin e farmacistit,
  - 3.2. Numrin e licencës,
  - 3.3. Arsyen për të cilën revokohet licenca,
  - 3.4. Faktin se revokimi është i përkohshëm apo i përhershëm.

### **Neni 22**

#### **Publikimi i regjistrit të farmacistëve të licencuar**

1. OFK do të publikojë çdo muaj listën më të re të farmacistëve të licencuar në ueb faqen zyrtare të OFK-së.
2. Të dhënat e publikuara do të jenë:
  - 2.1. Emri dhe mbiemri,
  - 2.2. Numri i licencës,
  - 2.3. Data e lëshimit të licencës,
  - 2.4. Data e skadimit të licencës.
3. OFK regjistrin e farmacistëve të licencuar do ta ndajë edhe me AKPPM, duke i shtuar këtyre të dhënave edhe numrin personal të farmacistit dhe popullimin e këtyre të dhënave në kohë reale në sistemin barnatari pas krijimit të sistemit elektronik të OFK.
  - 3.1. Me rastin e revokimit, pezullimit të ndonjë licence, OFK do të njoftojë edhe AKPPM dhe organet e tjera kompetente MSH, FSSH, SHSKUK, KPSH lidhur me vendimin.
4. Me rastin e krijimit të sistemit elektronik këto të dhëna do të jenë publike në kohë reale sipas përshkrimit në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

## KREU VII – DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 23

#### Dispozitat përfundimtare

1. Rastet të cilat nuk janë të parapara me Rregulloren e Komisionit për Licencim vendosen nga Këshilli Drejtues i OFK-së.
2. Me miratimin e kësaj rregullore shfuqizohet rregullorja për Regjistrimin dhe Licencimin e farmacistëve nga Kuvendi I.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i OFK-së.

Prishtinë 29/06/2019

Kryesuesi i Kuvendit të OFK-së  
Dr.sc. Ariantë Avni





**KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS**, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.1 të Ligjit nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësorë, nenit 20, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.1 të Statutit të OFK-së, në mbledhjen e mbajtur me 26/12/2020, miraton këtë:

## V E N D I M

### **PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORËS nr. 39 të datës 08.08.2019**

I. Pas nenit 8, shtohet neni 8A me këtë përmbajtje :

“ Neni 8A

Rilicencimi i farmacistëve të cilët pezullojnë ushtrimin e veprimtarisë

1. Farmacistët e rilicencuar të cilët në mënyrë vullnetare heqin dorë nga ushtrimi i veprimtarisë profesionale para skadimit të licencës së tyre, me rastin e rilicencimit i nënshtrohen provimit për rilicencim në kuadër të OFK-së.
2. Farmacistët të cilët pas skadimit të licencës së tyre, nuk i janë nënshtroar procesit të rilicencimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) e më shumë viteve, me rastin e rilicencimit i nënshtrohen provimit për rilicencim në kuadër të OFK-së.
3. Farmacistët nga paragrafi 1 dhe 2 konsiderohen se kanë 0 pikë kredituese nga EVP
4. Farmacistët nga paragrafet paragrafe vlerësohen në përputhje me nenin 8 të rregullorës “

II. Reformulohet përmbajtja e paragrafit 8 dhe 9 të nenit nenit 14 sipas përmbajtjes së mëposhtme :

“8. Faksimili ka këtë përmbajtje :

8.1 Llogo zyrtare e OFK-së

8.2. Thirrjen akademike dhe shkencore

8.3 Emrin dhe Mbiemrin

8.4 Thirrjen Profesionale për të cilën është licencuar

8.5 Numrin e Licencës.

8.6 Numri i anetaresise

9. Farmacisti aplikues sjell dëshmitë relevante për titujt për të cilët ka aplikuar për vendosje në faksimil si vendimin e noterizuar për caktimin e titullit akademik nga institucioni i akredituar arsimorë. ”

II. Autorizohet shërbimi profesional i OFK-së për spastrimin e tekstit të rregullorës 39 në përputhje me këtë vendim.

III. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen dispozitat e rregullorës nr. 39 të datës 08.08.2019 t që janë në kundërshtim me këtë vendim

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

**I'dërgohet:**

- **Komisionit për Licencim**
- **Shërbimit Profesional**

**Kryetari i OFK-së**

**Dr.sc. Arianit Jakupi**

